

VENDIM
Nr. 645, datë 19.9.2012

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT,
DATË 7.2.2012, PËR ÇËSHTJEN NR. 20134/05 “ALIMUÇAJ KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 19.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.2.2012, për çështjen nr. 20134/05 “Alimuçaj kundër Shqipërisë”, në shumën 8000 (tetë mijë) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit z. Vehbi Alimuçaj, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit z. Vehbi Alimuçaj, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit, brenda datës 9.10.2012.

Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e mësipërme, paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha